

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista - Shaheen për Rusinë, Ballkanin dhe NATO-n: Putin po tenton të na rraskapitë! Ka interes për t a destabilizuar
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917495/jeanne-shaheen-per-rusine-ballkanin-dhe-nato-n-putin-po-tenton-te-na-rraskapite-ka-interes-per-ta-destabilizuar-rajonin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:42:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 07:18:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d8eae477973554c3b512dd05ac49b905a8257a0606ae2e7c100f3faabf2c43f0
TEKSTI	a49c033fd530834d45d004061127eef0951c5876ed5e1ee46b5d4c06f436e4d1
PAMJA	c7c8d642f6d9f9d8b8edc18db1c69662d05710a0dccaba953be36bdd5b757b32

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e51ed787caa189d728b4b3a5868024ab8f4b391210e636e35f990f89d5d27e2a
E MËPARSHMJA	b613e0db4dbc8078e54ef6399532ba777662b21eaf7e8d9321bd8ef4164458ca
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e51ed787caa189d728b4b3a5868024ab8f4b391210e636e35f990f89d5d27e2a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



Shaheen për Rusinë, Ballkanin dhe NATO-n: Putin po tenton të na rraskapitë! Ka interes për ta destabilizuar

09:18, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Kongresi i ka dërguar presidentit amerikan, Donald Trump, një projektligj për sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Rusisë, duke hapur një fazë të re të presionit ekonomik të Uashingtonit ndaj Moskës.

Senatorja Jeanne Shaheen, demokratja më e lartë në Komitetin e Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe bashkëkryesuese e Grupit të Vëzhguesve të NATO-s në Senat, tha se legjislacioni synon të shënjestrojë të ardhurat financiare dhe energjetike të Rusisë dhe të rrisë presionin ndaj Kremlinit.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë më 17 shtator, Shaheen foli për projektligjin për sanksionet, nevojat urgjente të Ukrainës, luftën hibride ruse dhe aktivitetet e Moskës përgjatë krahut lindor të NATO-s. Ajo në këtë intervistë po ashtu foli për paqëndrueshmërinë në Ballkan dhe rolin e opozitës ruse në kundërshtimin e narrativit të Kremlinit për luftën.


"Presioni ndaj Putinit"

Kongresi sapo ka miratuar projektligjin për sanksionet ndaj Rusisë, legjislacioni i parë i madh dypartiak i Kongresit në mbështetje të Ukrainës që nga paketa e ndihmës emergjente e miratuar në prill të vitit 2024. Çfarë ndryshon për Moskën tani që legjislacioni po i dërgohet presidentit Trump për nënshkrim?

Jeanne Shaheen: Shpresoj se ky dërgon një mesazh të rëndësishëm. Ishte një votim me mbështetje shumë të fortë dypartiake në të dyja dhomat. Në Senat u miratua me 86 vota për dhe 11 kundër, ndërsa dje [v.j. 16 shtator] në Dhomën e Përfaqësuesve mori mbi 100 vota, me mbështetje të madhe dypartiake.

E mbështetën si demokratët, ashtu edhe republikanët. Ajo që do të bëjë është të godasë jo vetëm sektorin financiar të Rusisë, oligarkët dhe njerëzit përreth Vladimir Putinit që po ndihmojnë në zhvillimin e luftës së Rusisë. Do të godasë gjithashtu të ardhurat që po e financojnë këtë luftë, të ardhurat nga nafta dhe gazi.

më të lexuarat



Pakistani denon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës



Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe



Sulmet me dronë dhe raketa nga Irani/SHBA thirrje amerikanëve: Rishqyrtoni udhëtimet në Arabinë Saudite



Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s'duhet të prishen



Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët



BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë 'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut



Legjislacioni do të vendosë tani naaj pese vendeve kryesore qe perdoim naatën dhe gazin rus, qe janë kryesisht Kina dhe India. Ato janë përdorueset më të mëdha. Dhe, ajo që kemi dëgjuar nga India është se nëse ky projektligj miratohet ajo do të ndalojë blerjen e naftës dhe gazit rus.

Pra, shpresoj se ky legjislacion do t'i dërgojë një mesazh të fortë jo vetëm Putinit dhe Rusisë, por edhe Kinës dhe blerësve të tjerë të naftës dhe gazit rus. Ai po ashtu godet flotën në hije.

Por, ky është edhe një mesazh për Ukrainën. Dje patëm një konferencë për media ku udhëheqësit e të dyja dhomave folën për mesazhin që po u dërgojmë ukrainasve. Mesazhi është se ne e vlerësojmë guximin e tyre. Ata po luftojnë për demokracinë dhe lirinë dhe ne do të përpiqemi të bëjmë gjithçka që mundemi për t'i mbështetur.

Sa shpejt mund të fillojnë këto sanksione që të ushtrojnë presion të matshëm mbi ekonominë ruse dhe çfarë do të përcaktojë shpejtësinë me të cilën ato do të hyjnë në fuqi?

Jeanne Shaheen: Kjo varet nga administrata. Tani, presidenti po planifikon ta nënshkruajë këtë projektligj brenda një dite apo pak më shumë. Shpresojmë që, sapo të nënshkruhet, Departamenti i Thesarit të fillojë zbatimin e këtyre sanksioneve.

Ne kemi punuar shumë ngushtë me përfaqësuesin tregtar, ambasadorin Jamieson Greer, për legjislacionin, në mënyrë që ata të jenë të përfshirë dhe të shqyrtojnë vendet dhe mënyrën se si do të përcaktojnë se cilat prej tyre preken.

Prandaj, shpresojmë shumë se do të shohim veprime nga administrata sapo të miratohet projektligji.

Kritikët kanë vënë në pikëpyetje nëse sanksionet do të ndryshojnë vërtet llogaritjet e Moskës. Cilët tregues konkretë do të vëzhgoni në javët dhe muajt e ardhshëm për të kuptuar nëse masat po funksionojnë?

Jeanne Shaheen: Do të vëzhgojmë nga afër zbatimin e tyre. Dhe, nuk është vetëm pjesa e sanksioneve që mendojmë se është e rëndësishme, por edhe, siç thashë, ndërprerja e burimeve financiare.

Rusia merr mbi 50 për qind të të ardhurave të saj nga shitja e naftës dhe gazit. Dhe e dimë që Evropa tashmë është shkëputur nga nafta ruse dhe është në proces të shkëputjes edhe nga gazi rus. Por, ka vende të tjera në botë që nuk e kanë bërë këtë.

Në këtë drejtim, Kina është më e spikatura. Kina duhet ta marrë mesazhin se nëse dëshiron të vazhdojë të blejë gaz rus, nëse dëshiron të vazhdojë ta ndihmojë Rusinë të financojë dhe të paguajë për këtë luftë të paprovokuar që po vret civilë, që është e tmerrshme, dhe nëse Rusia po ka rreth 35.000 viktima në mesin e ushtarëve në muaj, atëherë Kina do të duhet të paguajë. Do të duhet të paguajë vlerën e tregut.

Nuk duhet të ketë më blerje të naftës dhe gazit në tregun e zi përmes flotës në hije, ku nuk paguhet çmimi i tregut.

Ukraina po hyn në një tjetër fazë të vështirë të luftës. Ju jeni në kontakt të rregullt me zyrtarët ukrainas. Çfarë i nevojitet më urgjentisht Kievit nga Uashingtoni tani?

Jeanne Shaheen: Mendoj se duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për t'iu dhënë penguesit që po u ndihmojnë ata të mbrohen nga raketat ruse.

Kjo është një sfidë sepse po hasim vështirësi me bazën tonë industriale të mbrojtjes, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por edhe te aleatët tanë evropianë. Mendoj se po përpiqemi të bëjmë gjithçka që mundemi për t'i siguruar Ukrainës këta pengues.

Duhet të sigurohemi që të kenë lidhje me Starlink, në mënyrë që të mund të ndjekin atë që po ndodh me raketat ruse. Dhe, duhet t'i ndihmojmë të përgatiten për një tjetër dimër shumë të ftohtë.

Duhet po ashtu të mendojmë për çdo mënyrë që mundemi për t'i bërë presion Vladimir Putinit që të ulët në tryezën e bisedimeve dhe ta ndalë këtë luftë. Ekonomia e tij po lëkundet. Siç thashë, ai ka 35.000 viktima në mesin e ushtarëve në muaj.

Aftësia për të kompensuar nevojën për ushtarë përmes rekrutimit po i kushton shumë para thesarit rus. Prandaj duhet të vazhdojmë të ushtrojmë sa më shumë presion që mundemi, jo vetëm Shtetet e Bashkuara, por të gjithë aleatët tanë.

Presidenti Trump ka folur për një armëpushim në fushën e energjisë mes Rusisë dhe Ukrainës. Në çfarë kushtesh mund të bëhet një armëpushim i kufizuar një

Trump kërcënon BE me ndërprerje të tregtisë nëse Kanadaja bëhet anëtare e asociuar

Arabia Saudite lëshon alarme emergjente për 'rrezik potencial' në Xheda, Mekë dhe Taif

128 persona ende të zhdukur pas fundosjes së tragetit në Indonezi, 109 të shpëtuar

rruge drejt një marrevesnjeje me të gjere.

Jeanne Shaheen: Mendoj se kjo varet nga mënyra se si strukturohet armëpushimi dhe nëse Rusia është vërtet serioze për t'u ulur në tryezën e bisedimeve. Deri tani, nuk ka qenë.

Vladimir Putini po i mban të gjithë në pritje, duke e zvarritur procesin edhe me administratën Trump dhe të dërguarit e saj, sepse mendon se mund të na rraskapitë, sa të heqim dorë.

Epo, mendoj se dje pamë një mesazh të fortë nga Kongresi, nga dy partitë, se nuk do ta lejojmë Putinin dhe Rusinë të na bëjnë të heqim dorë duke na rraskapitur. Do të bëjmë gjithçka që mundemi për të ushtruar presion ndaj tyre.

"Lufta hibride po ndodh që një kohë"

Rusia po përdor gjithnjë e më shumë dronë, sulme kibernetike, sabotime dhe mjete të tjera përtej Ukrainës. Sipas jush, ku përfundon lufta konvencionale dhe ku fillon lufta hibride?

Jeanne Shaheen: Lufta hibride po zhvillohet tash e një kohë dhe tani po shohim një intensifikim të saj.

Lajmi i mirë është se ukrainasit janë shumë novatorë. Ata kanë qenë një hap përpara teknologjisë ruse të dronëve dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbështetur këtë.

Kjo nuk është vetëm në interes të Ukrainës, është edhe në interes të Amerikës. Ajo që kemi parë në Lindjen e Mesme është se këta dronë kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme ndaj asetëve amerikane në Lindjen e Mesme.

Ne duhet të jemi sa më të avancuar në aspektin teknologjik në fushën e dronëve dhe kundërdronëve dhe Ukraina mund të na ndihmojë me këtë.

Në fakt, presidenti Zelensky, kur u takua rreth një muaj më parë me senatorët, e bëri këtë ofertë. Ai tha: "Ne duam të punojmë me ju për ta ofruar këtë teknologji".

Ju keni ngritur, në mënyrë specifike, shqetësime për aktivitetin rus përgjatë krahut lindor të NATO-s. Çfarë, sipas vlerësimit tuaj, po teston Moska në Baltik dhe në Poloni?

Jeanne Shaheen: Ai nuk po e teston vetëm në Baltik. Po e teston edhe në Poloni.

Ne e dimë se ai po e përdor. Sot patëm një seancë dëgjimore në Komitetin për Marrëdhëniet me Jashtë dhe një nga çështjet që u ngrit ishte fakti se Serbia ka shërbyer si një pikë ndalimi për rusët kur ata kryen sulmin në Lajpcig. Më pas u kthyen në Serbi.

Prandaj duhet të sigurohemi që po e luftojmë luftën hibride kudo që mundemi. Dhe kjo nuk është vetëm në interes të Amerikës, por edhe në interes të aleatëve tanë evropianë.

Sapo pamë Distriktin Jugor të Nju Jorkut që ngriti aktakuzë ndaj pesë rusëve, të cilët flasin për vrasjen e amerikanëve në Shtetet e Bashkuara. Ata janë banditë, janë mafiozë, janë të lidhur me Vladimir Putinin dhe ai i ka këta banditë, që po shënjestrojnë disidentët rusë, të cilët ndodhen ligjërisht në Shtetet e Bashkuara.

Nëse Rusia vazhdon të veprojë nën prapenë e një lufte të hapur, si duhet të duket përgjigjja e SHBA-së dhe e NATO-s?

Jeanne Shaheen: Mendoj se duhet të vazhdojmë të bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbështetur Ukrainën.

Duhet të vazhdojmë të punojmë me aleatët tanë të NATO-s dhe të jemi në gjendje t'u përgjigjemi disa prej këtyre sulmeve hibride. Ata po punojnë për këtë në mënyra që, mendoj, do të jenë të dukshme gjatë ditëve dhe muajve të ardhshëm.

Le të kthehemi te Serbia, por edhe te Ballkani më gjerësisht. Ju keni ngritur shqetësime për mundësinë e paqëndrueshmërisë, që mund të përfshijë Kosovën, Serbinë dhe Bosnjë e Hercegovinën. Cili është shqetësimi më i madh që keni sot për këtë çështje.

Jeanne Shaheen: Është lidhja që Serbia dhe serbët në Republikën Sërpska kanë me Rusinë dhe interesi i tyre për ta destabilizuar rajonin.

Rusia e sheh këtë si një front të dytë të mundshëm dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për të ruajtur stabilitetin në rajon. Duhet ta bëjmë të qartë se edhe ushtria jonë po e vëzhgon situatën nga afër.

Ne kemi një prani të NATO-s në Kosovë. Kemi misionin EUPOR në Bosnjë e Hercegovinë. Duhet të sigurohemi që rusët ta dinë se këto misione janë në qatishmëri të lartë dhe po e vëzhgojnë nga afër atë që po ndodh.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vjet burgim për krime lufte nga Gjykata Speciale në Hagë. Çfarë mund të nënkuptojë ky vendim për politikën e Kosovës dhe sigurinë rajonale?

Jeanne Shaheen: Nuk e di. Nuk kam pasur rastin që ta shqyrtoj këtë çështje, prandaj nuk mund të komentoj për këtë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Ofensiva ukrainase 'shpartallon' forcat ruse



Droni rus godet anijen turke në Ukrainë, raportohet për viktima dhe të plagosur



Erdogan për anëtarësimin e Turqisë në BE: Nuk është më prioriteti ynë, ata do të humbasin, jo ne

TË NGJASHME



Lufta në Iran/ Reagon Donald Trump: Do të marr një vendim të madh së shpejti



Përmbytjet shkatërruese në kufirin Nepal-Kinë, 1,453 viktima dhe mbi 6,600 të zhdukur



Aeroporti 'Charleroi' në Belgjikë anulon rreth 40 fluturime



Jemeni përfshihet nga luftime të reja, 125 mijë të zhvendosur; OKB paralajmëron për krizë ushqimore



Ukraina godet aeroportin ushtarak në Rostov, Rusia humb gjashtë helikopterë



'Trashëgimia'/ Goditet rrjeti ndërkombëtar i kokainës Brazil-Europë, trafikuan 4.6 tonë drogë



Lituania zbulon 12 tunele në kufirin me Bjellorusinë, dyshohet se do përdoren nga migrantët

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.